



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.105/2016

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Rafet Haxhaj dhe Adnan Konushevcu anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Nisma Për Kosovë dega në Drenas, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega Drenas, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Drenasit të datës 04.12.2016, në seancën e panelit të mbajtur me 05.12.2016, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa Anr.105/2016 e datës 04.12.2016 me te cilin është pretenduar se kandidati për kryetar të Komunës së Glllogocit për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme ka bërë thyerje të heshtjes zgjedhore me rastin e publikimit të posterit ne portalin “Lajmi.net”.

Arsyetim

Subjekti politik Nisma Për Kosovë, dega në Drenas, me datën 04.12.2016 ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën pretendohet se me datë 04.12.2016 në portalin “Lajmi.net”, është bërë publikimi i posterit të kandidatit të PDK-së Ramiz Lladrovci, veprime këto të cilat sipas parashtruesit të ankesës janë në kundërshtim me nenin 52.1 të LZP-së, në të ligj cilin theksohet se asnjë person apo medium nuk transmeton apo publikon çfarëdo material që i takon aktivitetit të fushatës.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si dëshmi një foto me posterin e kandidatit Ramiz Lladrovci nga subjekti politik PDK të publikuar ne portalin informativ gjatë ditës së heshtjes zgjedhore.

PZAP-i, në kuptim të nenit 6 paragrafi 6 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik PDK lidhur me ankesën e datës 04.12.2016, të parashtruar në PZAP nga subjekti politik Nisma Për Kosovë, si dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj kësaj ankesë deri më datë 05.12.2016 në ora 14:00.

PDK, në përgjigjen në ankesë, thekson se në asnjë rast nuk ka sponsorizuar asnjë poster në asnjë portal dhe media për kandidatin e saj jashtë rregullave dhe jashtë afateve dhe se të gjitha reklamimet e tyre i kanë dërguar deri me datën 02.12.2016 deri në ora 24:00 dhe se për reklamimet e mëvonshme është në përgjegjësi te portaleve dhe duke kërkuar që shkeljet e tilla të adresohen ndaj atyre që i kanë bërë shkeljet e tilla.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj pretendimet e palëve ne procedure dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se ankesa është e **pabazuar** për këto arsye:

PZAP-i vlerëson se pretendimi i parashtruesit të ankesës se posterit i kandidatit të subjektit politik PDK Ramiz Lladrovci, është në kundërshtim me nenin 52.1 të LZP-së, ngase i njëjti poster është publikuar në ditën e votimit, është i paqëndrueshëm dhe nuk është argumentuar nga parashtruesi i ankesës me asnjë provë dhe nuk është i bazuar në ligj. Sepse nga dy fotografitë e ofruara nga parashtruesi i ankesës nuk mund të vërtetohet, konstatohet se publikimi i posterit në fjalë është i publikuar me kohën dhe datën kur edhe pretendohet nga parashtruesi i ankesës.

Për më tepër data “04.12.2016” e cila gjendet e përshkruar në fotografit e ofruara nga parashtruesi i ankesës, PZAP-i konstaton se nuk është data e publikimit të posterit në fjalë por data e lartpërmendur është data e printimit të fotografisë.

Andaj ,nisur nga arsyet e theksuara më lartë, bazuar në nenin 5 par.7 pikat b) dhe c) të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, dhe lidhur me nenin 118 par. 1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.105 /2016 më datën 05.12.2016.



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur, mund të paraqet ankesë brenda afatit prej njëzet e katër (24)orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi në Gjykatën Supreme.